



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-8770/25 datë:22.04.2025



Npi – 01/159 datë: 02.05.2025

Bazuar në nenet 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenit 34 dhe 40 të Statutit të Komunës së Shtimes, Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008. Si dhe duke marrë për bazë propozimin nga Zyra e Kryetarit Nr.02/452 të datës 23.04.2025 për miratimin e Propozim-Vendimit për plotësimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete pranë Kuvendit të Komunës së Shtimes, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 02.05.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -IV- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 02.05.2025, me shumicën e votave miratoi, Vendimin për Plotësimin e Komitetit për Komunitete me anëtarë të ri si vijon:

1. Znj.Arjeta Maliqi – Shtime, nga komuniteti Ashkali.
2. Znj.Sabrie Velu – Shtime, nga komuniteti Ashkali.
3. Z.Artan Lubovci – Shtime, nga komuniteti Shqiptar.

II

Dorëheqje të pa revokueshme vullnetarisht, për arsye personale, nga KPK-ë kanë dhënë:

1. znj:Shkurte Behluli – Shtime, më datën: 05.11.2024.
2. z.Muhamet Mehmeti – Shtime, më datën: 03.02.2025.
3. znj. Shkurte Mustafa – Godanc më datën: 25.04.2025.

III

Komiteti për Komunitete pranë Kuvendit të Komunës së Shtimes do të ketë këtë përbërje të re:

Nr.	Emri e Mbiemri	Përfaqësimi	Subjekti
1	Bajram Ilazi	Kryesues i KPK nga komuniteti Ashkali	OJQ
2	Besnik Seferi	Anëtar i KPK nga Kuvendi	LVV
3	Rrezartë Ramadani	Anëtare e KPK nga Kuvendi	LDK
4	Artan Lubovci	Anëtar i KPK nga Kuvendi	AKR
5	Arton Demiri	Anëtar i KPK nga komuniteti Rom	PREBK
6	Sabrie Velu	Anëtare e KPK nga komuniteti Ashkali	OJQ
7	Arjeta Maliqi	Anëtare e KPK nga komuniteti Ashkali	IRDK

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryetarit, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi